


EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6126
E martë, 29 shtator 2020
çmimi 0.40 €

Qeveria themelon
Zyrën për Luginën
e Preshevës FAQE 3



FLET PËR "EPOKËN E RE", BLENDI KLOSI

Fushatën 'Pusho shqip në Shqipëri' ta përkthejmë në 'Pusho shqip në Kosovë'

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se këtë javë do të vijë në Prishtinë së bashku me disa nga kryetarët e bashkive për ta hapur sezonin vjeshtor në territorin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ai ka thënë se fushatën që promovuan në Shqipëri "Pusho shqip

në Shqipëri" tashmë duhet ta përkthejnë në "Pusho shqip në Kosovë". Ministri Klosi ka thënë se duhet të ketë shumë më tepër promovime turistike nga të dyja vendet që ky bashkëpunim të sjellë më shumë investime në botën e turizmit. Ai ka theksuar se me gjithë vështirësitet si pasojë e pandemisë Covid-19,

Shqipëria ka përmbyllur mirë sezonin turistik. "Ky vit padyshim se pati një ulje të konsiderueshme të pushuesve që vijnë në Shqipëri nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, por si asnjëherë tjetër pati mbështetje shumë të madhe nga pushuesit nga të gjitha trojet shqiptare", ka thënë Klosi FAQE 4-5

QEVERIA NDAN 87 MILIONË EURO PËR BIZNESET DHE QYTETARËT



Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej 87 milionë eurosh, ku 60 milionë prej tyre do të jenë vetëm për mbështetje të bizneseve të cilat do të përfitojnë varësish nga numri i punëtorëve që kanë. Kryeministri Avdullah Hoti ka dekluaruar se qeveria është duke i përbushur premtimet për ta përballuar sa më lehtë situatën e shkaktuar nga pandemia. Sipas tij, deri në fund të vitit do të ndahet edhe pjesa tjetër e fondit për rimëkëmbje ekonomike prej 365 milionë eurosh

1 475
RASTE
AKTIVE ME
COVID NË
KOSOVË FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Makedoni Xhepcisht-Tetovë Curëz-Ferizaj Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
E-mail: renova@mt.net.mk

NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

[facebook.com Gazeta "Epoka e re"](#)

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

JETA NË MESIN E TË
BARABARTËVE DHE KËSHILLAT
E ANTHONY FAUCIT F. 11

Nga Musa
SABEDINI



AKTUALE



SALIH MUSTAFA NUK
DEKLAROHET RRETH AKTAKUZËS
PËR KRIME LUFTE F. 2

SHSKUK-ja RIFILLON PUNËN NË
AMBULANCA SPECIALISTIKE DHE
INTERVENIME KIRURGIKE
JOEMERGJENTE F. 6

EKONOMI

DYFISHOHEN SUBVENCIONET
PËR VITIN 2020 F. 8

REÇICA: NUK DO TË LEJOJMË
TË NËPËRKËMBEN TË DREJTAT E
PENSIONISTËVE F. 8

KULTURË

LIBRI
"BLEIBENDE
SPUREN"
DO TË
PREZANTOHET
PËR TË
DHJETËN HERË F. 13



Lesung und Gespräch mit der Autorin Basile Sakiri-Maurer und Eva Bachmann.

Raum für Literatur

Freitag, 02.10.2020, 19:00

Lulëzim ETEMAJ



**Kolegji
BIZNESI**
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A.
DEGA KOSOVE
Ruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë.
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302.
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Salih Mustafa nuk deklarohet rreth aktakuzës për krimë lufte



Ish-eprori i Ushtirisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, nuk është deklaruar nëse ndihet fajtor ose jo në seancën e parë që është zhvilluar ndaj tij në gjykatën e Dhomave të Specializuar me seli në Hagë. Avokati i Mustafës nuk përjashtoi mundësinë që mbrojtja ta kontestojë ligjshmërinë e Dhomave të Specializuar

HAGË, 28 SHTATOR - Ish-eprori i Ushtirisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), Salih Mustafa, gjatë paraqitjes së parë para Dhomave të Specializuar në Hagë të hënën, ka zgjedhur që të mos deklarohet rreth akuzave për krimë lufte që rëndojnë ndaj tij. "Nuk do të deklarohem sot, do të konsultohem me avokatin", ka thënë Mustafa, i cili do të mbesë në paraburgim. Sipas rregullave të Dhomave të Specializuar, Mustafa ka të drejtë që në një periudhë brenda 30-ditësh të deklarohet i pafajshëm apo i fajshëm për akuzat ndaj tij.

Aktakuza e konfirmuar e ngarkon Mustafën për ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme. Krimet për të cilat akuzohet Mustafa, sipas aktakuzës,

dyshohet se janë kryer gjatë muajit prill të vitit 1999 në një qendër ndalimi në fshatin Zllash që ndodhet në rrëthinën e Komunës së Prishtinës. Gjatë seancës publike është thënë se "ekziston dyshimi i bazuar mirë, se z. Mustafa është përgjegjës për kryerjen e këtyre krimeve".

Avokati i Mustafës, i caktuar nga gjykata, Julius Von Bone, tha se mbrojtja mund ta sfidojë legitimitetin e Dhomave të Specializuar. "Mbrojtja në këtë moment nuk e përjashton mundësinë e dorëzimit të mocioneve të cilat kundërshtojnë juridikcionin apo ligjshmërinë e gjykatës dhe fakti që jemi këtu sot nuk do të thotë se mbrojtja e pranon gjykatën si të tillë, por këtë do ta bëjmë me kalimin e kohës përmes mocioneve

tona", ka pohuar Bone, i cili ka kërkuar që i gjithë dokumentacioni i rastit të klientit të tij të jetë i qasshëm në gjuhën shqipe dhe në letër. Gjyqtari i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, në

fillim të seancës ia levoi veprat për të cilat akuzohet se Mustafa i ka kryer gjatë vitit 1999. Po ashtu, Mustafa u informua nga gjyqtari i procedurës paraprake për të drejtat e tij si dhe iu tha se ka

të drejtë ta kundërshtojë masën e paraburgimit. Mustafa u arrestua më 24 shtator në shtëpinë e tij që gjendet në periferi të Prishtinës, pasi i ishte konfirmuar aktakuza për dyshimet për kryerjen e krimave të luftës, përfshirë këtu veprat penale si: ndalim arbitrar, trajtim mizor, torturë dhe vrasje të paligjshme. Arrestimi i Mustafës ishte i pari që nga themelimi i Dhomave të Specializuar dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar që njihen edhe si Gjykata Speciale në vitin 2015.

Pas konfirmimit të aktakuzës dhe paraqitjes së parë të të akuzuarit, gjykatësi i procedurës paraprake bashkërendon komunikimin ndërmjet palëve deri në momentin kur çështja i kalohet trupit gjykues dhe siguron që të mos ketë vonesa dhe merr të gjitha masat e nevojshme për përgatitjen e shpejtë të çështjes për gjykim.

Përfundon intervistimi i Çekut nga Prokuroria në Hagë

Të hënën ka përfunduar intervistimi i ish-kryeministrit të Kosovës, Agim Çeku, nga Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë. Lajmin e ka konfirmuar avokati Artan Qerkini, i cili nuk ka treguar nëse Çeku është mbrojtur në heshtje apo u është përgjigjur pyetjeve të prokurorëve.

Çeku, ish-komandant i Shtabit të Përgjithshëm të Ushtirisë Çlirimtare të Kosovës, më herët gjatë këtij muaji kishte thënë se ai është ftuar nga Zyra e Prokurorit të Specializuar për intervistim në cilësinë e të dyshuarit.



Policia e Kosovës pranon donacion nga ShBA-ja

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Policia e Kosovës ka pranuar donacion nga Ambasadat e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA-së), përkatësisht Byroja për Çështje Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) dhe USDOJ-ICI-TAP-i. Te Policia e Kosovës u

transferua një automjet dhe pajisje të përdorura nga fusha e teknologjisë informative si kompjuterë, printerë dhe skanerë.

Ky donacion i automjetit të përdorur dhe pajisjeve të përdorura ka për synim ta ndihmojë Policinë e Kosovës përmirësimin e kushteve të

punës duke mundësuar kryerjen me efikasitet të punëve të përditshme.

Policia e Kosovës, në këtë rast Drejtori i Përgjithshëm i PK-së, Rashit Qalaj, ka falenderuar Ambasadën e ShBA-së përkrahjen e vazhdueshme përgjithësive kapaciteteve të Policisë së Kosovës.



Kosova dhe EMCDDA arrijnë marrëveshje për luftimin dhe eliminimin e problemit me drogat

EPOKA
E BE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR -
Ministria e Punëve të Brendshme, si bartëse e politikave për luftimin e narkotikëve, ka iniciuar në vitin 2019 kërkesën për nënshkrim të Marrëveshjes së Punës me Qendrën Evropiane për Monitorimin e Drogës dhe Varësisë nga Dropa (EMCDDA), e cila është një nga Agjencitë e Bashkimit Evropian. Kjo marrëveshje u nënshkrua të hënën nga

ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe drejtori i EMCDDA, Alexis Goosdeel. Me këtë rast, ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka theksuar se Ministria e Punëve të Brendshme, si bartëse e Strategjisë kundër Narkotikëve dhe Planit të Veprimit 2018-2022, është e angazhuar maksimalisht përfuqizimin dhe zbatimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e narkotikëve.

Ministri Veliu u zotua se Ministria e Punëve të Brendshme është dhe do të vazhdojë të jetë partnere serioze për luftimin dhe eliminimin e problemit me drogat, si dhe për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të raportimit të problemeve dhe zgjidhjeve në fushën e drogave në nivel vendi. Sipas Velit, EMCDDA është adresa kompetente dhe me kredibile mbi të dhënat e drogave në BE e që edhe ky fakt përbën një element shtesë për ta ngritur bashkëpunimin e Kosovës në

një nivel edhe më të avancuar. Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka theksuar se ndihet i kënaqur për finalizimin e një marrëveshje kaq të rëndësishme që i jep një dinamikë punës së përbashkët dhe punës përfuqizimin e politikave nga legjislacioni i BE-së për monitorimin e drogave. Gjithashtu, drejtori i EMCDDA, Alexis Goosdeel, u shpreh i lumtur se tashmë ka një siguri të mirë të bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës

dhe Bashkimit Evropian për luftimin dhe eliminimin e problemit me drogat. Bashkëpunimi me EMCDDA zhvillohet tash e disa vite, e që është realizuar përmes pjesëmarrjes në takime të ndryshme rajonale, punëtori, trajnime dhe përgatitje të raporteve. Pikë kontakti e MPB-së është Sekretariati i Strategjive deri kur do të themelohet Observatori i Drogave, kërkesë kjo e EMCDDA, si dhe një nga kriteret për liberalizimin e vizave.



Opozita thotë se qeveria nuk ka mbështetje në Kuvend, Hoti thotë se koalicioni është stabil

EPOKA
EPOKA

Oendresa RAMA

PRISHTINË, 28 SHTATOR -
Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë të hënën se koalicioni aktual qeverisës është duke funksionuar dhe se qeveria e tij është stabile. "Nuk shoh arsy që të hyjmë në kombinime të tjera", ka thënë Hoti, pasi është pyetur nga gazetarët për përfshirjen e mundshme të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) në qeveri

Në fundjavën që lamë pas, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka thënë se partia që drejton ka hequr vijat e kuqe ndaj partive politike në vend, duke përfshirë edhe PDK-në.

edhe PDK-në.
Mustafa ka thënë se derisa Kosova po ballafaqohet me akuzat e Gjykatës Speciale, bisedimet me Serbinë dhe pandeminë Covid-19, është e pakuptimtë të mos kërkohet

bashkëpunim në skenën politike. Përfaqësuesit e opozitës kanë reaguar ndaj deklaratës së kryeministrit Avdullah Hoti se koalicioni qeverisës që drejton ai është stabil.

Ish-ministrja e Drejtësisë dhe zyrtarja e lartë e Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, ka shkruar në llogarinë e vet në "Facebook", se Hoti paska thënë se koalicioni eshtë stabil ani pse në Kuvend nuk po i kanë numrat asnjë çështje ta shtynë përpara, madje as për projektligjet që, sipas tyre, janë më të rëndësishme nuk po arrijnë t'i bëjnë 61 vota. "Stabiliteti i karriges eshtë me rëndësi për të. Hoti nuk ka mbështetje as në Kuvend dhe as nuk ka mbështetje qytetare. Secili kryeministër do të dorëhiqej ose do të kërkonte votëbesim. Por, Hoti e do shumë pushtetin dhe nuk do ta bëjë asnjëren dhe as tjetrën, prandaj sa më parë partitë duhet t'i jepin



nënshtkrimet për largimin e kryeministrat, i cili jo vetëm se ishte përfqafuar me Vuçiqin (siç kuptuam nga presidenti Trump) i cili ka qenë krah i Millosheviqit

e ka bërë gjenocid në Kosovë, por ka përqafuar edhe se cilën kërkesë të Serbisë në zotimet e tij”, ka shkruar Haxhiu. Koalicioni aktual qeverisës në

Kosovë përbëhet nga Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, Nisma Socialdemokrate dhe partitë e pakicave.

FLET PËR "EPOKËN E RE", BLENDI KLOSI

FUSHATËN “PUSHO SHQIP NË SHQIPËRI” TA PËRKTHEJMË NË “PUSHO SHQIP NË KOSOVË”

Ministri i Turizmit dhe Mjedisit të Shqipërisë, Blendi Klosi, ka thënë se këtë javë do të vijë në Prishtinë së bashku me disa nga kryetarët e bashkive për ta hapur sezonin vjeshtor në territorin e Kosovës. Në këtë intervistë dhënë gazetës “Epoka e re”, ai ka thënë se fushatën që promovuan në Shqipëri “Pusho shqip në Shqipëri” tashmë duhet ta përkthejnë në “Pusho shqip në Kosovë”. Ministri Klosi ka thënë se duhet të ketë shumë më tepër promovime turistike nga të dyja vendet që ky bashkëpunim të sjellë më shumë investime në botën e turizmit. Ai ka theksuar se me gjithë vështirësitë si pasojë e pandemisë Covid-19, Shqipëria ka përmbyllur mirë sezonin turistik. “Ky vit padyshim se pati një ulje të konsiderueshme të pushuesve që vijnë në Shqipëri nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, por si asnjëherë tjetër pati mbështetje shumë të madhe nga pushuesit nga të gjitha trojet shqiptare”, ka thënë Klosi

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Ministri i Turizmit dhe Mjedisit në Shqipëri, Blendi Klosi, ka thënë se me gjithë vështirësitë si pasojë e pandemisë Covid-19, Shqipëria ka përmbyllur mirë sezonin turistik. Në këtë intervistë dhënë për gazeten “Epoka e re”, Klosi ka bërë me dije se së bashku me kryetarët e bashkive dhe përfaqësuesit e agjencive turistike do të vijnë për vizitë këtë javë në Kosovë për ta hapur sezonin vjeshtor në territorin e Kosovës. Sipas tij, fushatën “Pusho shqip në Shqipëri” tanimë duhet ta përkthejmë në “Pusho shqip në Kosovë”. “Ne do të mbajmë premtimin dhe këtë javë do të jem në Prishtinë së bashku me kryetarët e bashkive, për ta hapur sezonin vjeshtor në zonën e Kosovës dhe nga aty të bëjmë thirrje që ta promovojmë turizmin shqiptar në përgjithësi. Gjithashtu, me mua në Kosovë do të janë të pranishëm një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve të hotelerisë dhe strukturash të operatorëve turistik që fushatën ‘Pusho shqip në Shqipëri’ ta përkthejmë në ‘Pusho shqip në Kosovë’. Pra, që gjithë shqiptarët kudo që janë t'i njojin bukuritë që ka Prizreni, Prishtina, Peja, Gjakova dhe Alpet e Kosovës”, ka thënë ai. Ministri Klosi ka thënë se duhet



Naim Qelaj, Avokat i ri i Popullit

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Kuvendi i Kosovës ka zgjedhur të hënën kandidatin Naim Qelaj, Avokat të Popullit, për një mandat pesëvjeçar. Me 69 vota për, 5 kundër dhe 3 abstenime, deputetët zgjodhën kandidatin Naim Qelaj për Avokat të Popullit. Të premten në raundin e dytë të votimit ishte Xhavit Shala që mori 22 vota,

kurse Naim Qelaj 32. Ky i fundit kaloi në raundin e tretë, për të cilin u votua të hënën. Avokati i sapozgjedhur i Popullit, Naim Qelaj, në betimin e tij para deputetëve ka premtuar se do të punojë në mënyrë të pavarur dhe të paanshme për t'i avancuar të drejtat dhe liritë e njeriut në vend. “Unë betohem dhe premoj solemnisht se do të



të ketë shumë më tepër promovime turistike nga të dyja vendet që ky bashkëpunim tē sjellë më shumë investime në botën e turizmit. Ai ka theksuar se Kosova ka nevojë që të ketë më tepër kapacitete në fushën e turizmit.

"Epoka e re": Z. Klosi, si ka shkuar sezoni turistik këtë verë në Shqipëri?

Klosi: Në fillim ka qenë një sezoni turistik goxha me stres dhe me shumë pikëpyetje, por

tani ndihem mirë. Në këtë kohë kur po takohem me ju jam duke bërë edhe një tur falënderimesh për hoteleritë shqiptare të cilat ia dolën tē dëshmojnë se ne kemi një strukturë të fortë hoteliere dhe jemi të gatshëm t'i mirëpresim turistët nga shumë vende të botës. Ky vit padyshim se pati një ulje të konsiderueshme të pushuesve që vijnë në Shqipëri nga vende të ndryshme të Bashkimit Evropian, por si asnjëherë tjetër pati mbështetje shumë të madhe nga pushuesit nga të gjitha trojet shqiptare, ku shtuan shifra rekordë për bregdetin tonë. Për këtë mund tē them se pati një drojë se s'do të jemi si vitin e kaluar, megjithatë në masën më të madhe patëm numër të konsiderueshëm të pushuesve.

"Epoka e re": Në kuadër të fushatës "Pusho shqip" ju promovuat edhe Kosovën. Kishte interesim nga Shqipëria pér tē ardhur mandej në Kosovë?

Klosi: Doli shumë interesante fushata që krijuam dhe promovuam së bashku. Unë lansova fushatën së bashku me mikun tim, ministrin e Tregtisë dhe Industrisë nga Kosova, Vesel Krasniqi, të cilën e quajtëm "Pusho shqip", për t'u kërkuar pushuesve tanë që t'i njohin pasuritë turistike nga të dyja anët e bjeshkëve. Mendoj se bregdeti shqiptar i takon gjithë shqiptarisë dhe s'ka pse tē trajtohet si diçka që i takon Shqipërisë dhe jo Kosovës, pra eshtë një bregdet që perëndia ia ka dhënë tē gjithë shqiptarisë. Prandaj, themi se na duhet shumë që ta pranojmë se kjo pasuri kombëtare duhet tē shfrytëzohet dhe tē jetë një mbështetje nga të dy krahët e shqiptarisë. Mirëpo, më tepër sesa kaq, ne do ta mbajmë premtimin dhe këtë javë do tē jem në Prishtinë së bashku me kryetarët e bashkive, për ta hapur sezonin vjeshtor në zonën e Kosovës dhe nga aty tē bëjmë thirrje që ta promovojmë turizmin shqiptar



në përgjithësi. Gjithashtu, me mua në Kosovë do të janë të pranishëm një numër i konsiderueshëm i përfaqësuesve të hotelerisë dhe strukturash të operatorëve turistikë, në mënyrë që fushatën "Pusho shqip në Shqipëri" ta përkthejmë në "Pusho shqip në Kosovë". Pra, që gjithë shqiptarët kudo që janë t'i njohin bukuritë që ka Prizreni, Prishtina, Peja, Gjakova dhe Alpet e Kosovës. Besoj kjo eshtë edhe filozofia që ndajmë me kolegët e Kosovës, ministrat atje, që ta kemi komunitetin e të pushuarit shqip pa e kuptuar se ku eshtë kufiri.

"Epoka e re": Nga këndvështrimi juaj, sa ka kapacitete Kosova pér ta zhvilluar turizmin dhe çfarë rekomandimesh keni?

Klosi: Në Shqipëri kemi pak vite, por investimet në botën e hotelerisë janë tē fundme, pra nuk janë prej shumë kohësh dhe kjo na ka ndihmuar që tē tregojmë se kemi forcë pér zhvillimin e turizmit. Fatkeqësisht në Kosovë ende nuk po ndihet e njëta valë e cila ka filluar në tē gjithë rajonin sa i përket turizmit.

Padyshim se edhe pandemia e ka dëmtuar këtë lloj filozofie, por besoj se me kalimin e pandemisë përsëri do të rikthehet lëvizja në mënyrë që tē vazhdojë zhvillimi i turizmit. Duhet tē ketë shumë më tepër promovime turistike nga të dyja vendet, pra që tē kemi më shumë investime në botën e turizmit. Kosova ka nevojë që tē ketë më tepër kapacitete në fushën e turizmit.

"Epoka e re": Z. Klosi, pse nuk vijnë në Kosovë nxënësit e arsimit parauniversitar të Shqipërisë, ashtu siç vijnë këtu ata të Kosovës?

Klosi: Kjo eshtë një praktikë që duhet tē bëhet me shumë detyrim në arsimin tonë fillor dhe tē mesëm për ta njohur më shumë trashëgiminë kulturore, historike dhe natyrore tē përbashkët. Por, përsëri po them se mungesa e kapaciteteve hoteliere bën që operatorët turistikë që merren me këtë biznes e kanë shumë tē vështirë tē organizojnë aktivitete tē tillë. Kosova nuk ka akoma kapacitete komanduese tē niveleve tē pranueshme që pranojnë turistë me kapacitete tē nevojshme pér nxënësit e shkollave. Megjithëkëtë,

operatorët turistikë para situatës së pandemisë e kanë pasur brenda ofertës së tyre edhe Kosovën.

"Epoka e re": Çfarë eshtë duke ndodhur me portin e Shëngjinit, u fal apo s'u fal, pasi ekziston njëfarë mjegullie në Kosovë sa i përket këtij porti.

Klosi: Ajo çfarë u intereson qytetarëve të Kosovës dhe gjithë shqiptarës, eshtë se bregdeti eshtë një dhe i vetëm. Në qoftë se ka një zhvillim tē qëndrueshëm në Shëngjin dhe Velipojë, kjo eshtë falë ndjesisë që qytetarët e Kosovës e konsiderojnë si bregdetin e tyre, dhe aty jo vetëm pushuesit, por edhe një numër i konsiderueshëm biznesesh menaxhojnë me të. Kjo eshtë falë investimeve në Autostradën e Kombit dhe investimeve të faktorit ndërkombëtar. Po ashtu, Kosova ka firmosur me Shtetet e Bashkuara të Amerikës marrëveshjen pér tē pasur një linjë tē drejtëpërdrejtë me autostradën e Nishit. Ne do tē kemi investime në Velipojë, Shëngjin, Durrës, Sarandë, Vlorë dhe shumë shpejt duhet tē mendojmë pér shtimin dhe menaxhimin e kapaciteteve tona kombëtare.

Kryeministri Hoti vizitoi Ipeshkvinë e Kosovës

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Kryeministri Avdullah Hoti, i shoqëruar nga ministrja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Vlora Dumoshi dhe zëvendësministrja e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Teuta Sahatqija, e emëruar nga kryeministri Hoti si pikë kontakti e Qeverisë së Republikës së Kosovës me Selinë e Shenjtë në Vatikan, ka vizituar Ipeshkvinë e

Kosovës, ku eshtë pritur nga Ipeshkvi Dodë Gjergji. Gjatë këtij takimi kryeministri Hoti e falënderoi Imzot Dodë Gjergjin për mirëkuptimin e Ipeshkvisë së Republikës së Kosovës dhe tē tē gjithë komunitetit katolik tē vendit ndaj masave tē qeverisë dhe tē institucioneve shëndetësore tē vendit pér menaxhimin dhe parandalimin e pandemisë Covid-19,

tē cilat, sigurisht, kanë prekur veprimtaritë e bashkësive dhe tē komuniteteve fetare. Po ashtu, kryeministri Hoti e vlerësoi rolin e Ipeshkvisë së Kosovës në tē gjitha proceset historike nëpër tē cilat ka kaluar Kosova si dhe kontributin e saj tē rëndësishëm në jetën e përgjithshme shqërore, kulturore e shpirtërore tē vendit.

"Harmonia dhe bashkëpunimi i ngushtë i bashkësive fetare ka krijuar përherë një frymë tē veçantë dashurie, mirëkuptimi e tolerance ndërmjet etnive dhe besimeve tē ndryshme në Kosovë", tha kryeministri Hoti. Ndërsa ipeshkvi i Ipeshkvisë së Kosovës, Imzot Dodë



Gjergji, e falënderoi kryeministrin Hoti pér vizitën, pér mbështetjen e përhershme tē qeverisë si dhe pér miratimin e Projektit pér liritë fetare.

Raporti 24-orësh i IKShPK-së: 142 të shëruar, tre të vdekur dhe 48 raste të reja me Covid-19

1 475 raste aktive me Covid në Kosovë

Në Kosovë që nga marsi i këtij viti janë paraqitur 15 520 raste pozitive me Covid-19, prej tyre 13 420 janë shëruar dhe 625 kanë vdekur. Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur tre persona, janë shëruar 142 dhe janë paraqitur 48 raste të reja me Covid. Sipas IKShPK-së, në vendin tonë janë aktive edhe 1 475 raste me virusin "Korona"

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë vdekur tre persona, janë shëruar 142 dhe janë paraqitur 48 raste të reja me Covid. "Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK dhe laboratorët privatë, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 645 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 48 raste pozitive. Brenda 24 orëve janë raportuar 3 raste të vdekjes me SARS CoV-2 pozitiv (1 rast nga spitali Prizren, 1 rast nga spitali Gjakovë dhe 1 rast nga spitali Gjilan). Numri total i rasteve pozitive është 15 520 raste nga 66 624 persona të dyshimtë me virusin SARS-CoV-2 dhe 625 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 142 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri me sot është gjithsej 13 420 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 475", ka njoftuar IKShPK-ja, duke treguar rastet e reja sipas komunave. "Rastet



pozitive janë nga: komuna Prishtinë 10 raste, komuna Mitrovicë 5 raste, komuna Pejë 5 raste, komuna Suharekë 5 raste, komuna Drenas 4 raste, komuna Gjilan 4 raste, komuna Podujevë 3 raste, komuna Prizren 3 raste, komuna Klinë 2

raste, komuna Vushtrri 2 raste dhe me nga një rast komunit Fushë Kosovë, Kamenicë, Obiliq, Rahovec dhe Viti. Mbuloni gojën dhe hundën me maskë! Mbani higjenën! Respektoni distancën!", ka njoftuar IKShPK-ja.

të hënën, ka thënë se lirim i masave kundër Covid-19 nënkuption shtimin e përgjegjësisë. Ai ka thënë se rikthimi i shërbimeve shëndetësore nuk duhet që të krijojë lehtësira të mëdha sa i përket lirimit të masave kundër koronavirusit. "Nuk duhet të na krijojë lehtësira të mëdha, pasi vendet e rajonit janë duke iu eksposuar rikthimit të infekzionit, duhet të kemi kujdes".

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, në një konferencë për media mbajtur

Bie numri i pacientëve që po trajtohen në QKUK dhe spitalet rajonale

Shërbimi Spitalor Klinik Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka njoftuar se gjithsej 183 pacientë janë të konfirmuar pozitivë me virusin "Korona". Në njoftimin e ShSKUK-së është janë duke u trajtuar në QKUK dhe në spitalet rajonale të Kosovës. Nga këta pacientë, 106

janë të konfirmuar pozitivë me virusin "Korona". Në njoftimin e ShSKUK-së është thënë se 101 pacientë janë me oksigenoterapi, prej tyre 4 në respiratorë dhe 7 me CPAP maskë.

ShSKUK-ja rifillon punën në ambulanca specialistike dhe intervenime kirurgjike joemergjente

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Bazuar në vendimin e datës 25 shtator të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në Shërbimin Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës (ShSKUK) kanë rifilluar të ofrohen shërbimet shëndetësore joemergjente. Nga dita e hënë ka filluar puna në ambulancat specialistike në QKUK, po ashtu programi elektiv i operacioneve, gjithnjë duke respektuar rekomandimet dhe masat e parapara për mbrojtje nga Covid-19.

Me rastin e rifillimit të shërbimeve, Valbon Krasniqi, ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të ShSKUK-së, ka thënë se pas shumë javësh dhe muajsh të lajmeve lidhur me



numrin e të infektuarve dhe masat që janë ndërmarrë në vazdimësi, sot ka lajme të mira. "Situata epidemiologjike dhe aspekti klinik i pacientëve të prekur nga Covid dhe vendimi i qeverisë i datës 25 shtator lejon dhe mundëson që ShSKUK ta fillojë rikthimin

gradual të të gjitha shërbimeve shëndetësore për pacientët me nevojë. Ju ishit dëshmitarë në vizitat që bëmë bashkë në ambulanca, nga sot kanë filluar shërbimet në ambulanca specialistike të QKUK-së", është shprehur ai. Drejtori Krasniqi ka bërë me

dije se ka njoftuar edhe drejtorët e spitaleve të përgjithshme të cilët janë udhëzuar që konform vendimeve dhe situatës epidemiologjike dhe konform numrit të pacientëve që kanë, ta rifillojnë rikthimin gradual të shërbimeve shëndetësore për pacientët e tyre. Sipas tij, krahas rikthimit të shërbimeve specialistike, të gjithë drejtorët e klinikave dhe të spitaleve të përgjithshme, po ashtu janë udhëzuar ta bëjnë planin e hollësishëm për rifillim të programeve elektive të intervenimeve kirurgjike. Ai i luti qytetarët dhe pacientët që kanë nevojë për shërbime në spitalet tona, t'i respektojnë në mënyrë strikte masat e rekomanduara për parandalim të infekzionit, ta respektojnë orarin dhe terminët e

përcaktuar nga ana e stafit shëndetësor dhe t'i marrin shërbimet ashtu si kanë planifikuar. Në anën tjetër, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se me rikthimin e shërbimeve do të rritet edhe kujdesi ndaj situatës pandemike. "Ne jemi pajtuar për rikthimin e operacioneve joemergjente. Sot së bashku me të gjithë pamë për së afërmim punë e palodhshme. Kjo tregon seriozitetin e mjekëve dhe infermierëve", u shpreh ministri Zemaj. Ai ka theksuar se kjo gjendje do të jetë sfiduese për personelin shëndetësor dhe apeli vazhdon që të jetë respektimi i masave nga të gjithë ngaqë vetëm kështu mund ta ndihmojmë personelin shëndetësor që ta kryejë punën e vet.

Qeveria e Kosovës u ka dalë në ndihmë shqiptarëve të Luginës së Preshevës

Qeveria themelon Zyrën për Luginën e Preshevës

Qeveria e Kosovës ka themeluar zyrën për ofrimin e assistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës. Kjo zyre, e cila do të ofrojë mbështetje për qytetarët që jetojnë në rajonin e Luginës së Preshevës, do të funksionojë në kuadër të Zyrës së Kryeministratit. Me këtë rast, kryeministri Avdullah Hoti ka dekluaruar se shqiptarët e Luginës po përballen me probleme dhe vështirësi të ndryshme dhe se kjo zyre do të ofrojë assistencë atyre në shumë aspekte. Ky veprim i qeverisë është mirëpritur nga përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës

EPOKA
ERE**Muhamed KOCI**

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për themelimin e zyrës për ofrimin e assistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës në kuadër të Zyrës së Kryeministratit. Përmes kësaj zyre, bazuar në legjislacionin në fuqi, Qeveria e Kosovës do të angazhohet t'i ndërmarrë masat e nevojshme që të lehtësojë dhe përmirësojë jetën e qytetarëve që jetojnë në Luginën e Preshevës në fushën e arsimit, kulturës dhe ekonomisë. Sipas vendimit të qeverisë, zyra do të trajtojë edhe çështje të tjera që nuk janë listuar në këtë vendim, por që dalin si kërkesa dhe nevoja eventuale nga qytetarët që jetojnë në Luginën e Preshevës.

Pas mbledhjes së qeverisë, kryeministri Avdullah Hoti ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta ofrojë assistencën e saj që ta lehtësojë jetën e tyre, duke u kujdesur për ta përmes Zyrës së Veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministratit", ka thënë Hoti. Ky veprim i qeverisë është mirëpritur nga përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës.

Kryetari i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Luginë të Preshevës, Ragmi Mustafa, ka falënderuar kryeministrin Avdullah Hoti për këtë vendim. "Këshilli Kombëtar Shqiptar mirëpret dhe vlerëson vendimin për themelimin e zyrës për ofrimin e assistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës. Duke marrë parasysh problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët e Luginës së Preshevës, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta ofrojë assistencën e saj që ta lehtësojë jetën e tyre, duke u kujdesur për ta përmes Zyrës së Veçantë në kuadër të Zyrës së Kryeministratit", ka thënë Hoti. Ky veprim i qeverisë është mirëpritur nga përfaqësuesit politikë të shqiptarëve të Luginës së Preshevës.



për ofrimin e assistencës për qytetarët e Luginës së Preshevës në kuadër të Zyrës së Kryeministratit. Me këtë rast, falënderova sot përmes një bisede telefonike kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Avdullah Hoti, për këtë vendim jashtëzakonisht të rëndësishëm drejt institucionalizimit të çështjes së Luginës së Preshevës nga Republika e Kosovës", ka shkruar Mustafa në llogarinë e vet në "Facebook". Ai ka shtuar se hapja e kësaj zyre është padashim një nga vendimet më të rëndësishme që kanë ndërmarrë qeveritë e Kosovës që nga paslufta. "Sado që mund të duket simbolike, kjo zyre është fillim i veprimit institucional dhe

shtetëror të Kosovës sipas praktikave të shteteve me demokraci të zhvilluar, të cilat kujdesen institucionalisht përruajtjen dhe zhvillimin e të drejtave të bashkëkombësve të tyre jashtë kufijve shtetërorë. Urojmë që kjo zyre tanimë mënjanon politikat improvizuese qeveritare dhe fillon qasjen institucionale dhe shtetërore në koordinimin, adresimin dhe zgjidhjen e sfidave të qytetarëve shqiptarë të Luginës së Preshevës", ka thënë ai.

Mustafa ka theksuar se ndërlidhja institucionale në mes të Luginës së Preshevës dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Shqipërisë është jetike për shqiptarët e këtij rajoni. Hapjen e kësaj zyre e ka

mirëpritur edhe kryetari i Komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri. Në profilin e vet në "Facebook" ai ka shkruar se vonesat për hapjen e kësaj zyre kanë qenë të paarsyeshme. "Jam i lumtur që, më në fund, Qeveria e Kosovës e zbatoi njëren nga pikat e Rezolutës së Kuvendit të vitit 2013 për hapjen e Zyrës së Prishtinë lidhur me ofrimin e assistencës për qytetarët e Kosovës Lindore për t'i zgjidhur problemet e natyrave të ndryshme. Vonesa prej shtatë vjetësh nuk arsyetohet kurssesi, por mirë që u bë më në fund. Faleminderit kryeministrit Hoti, kabinetit qeveritar dhe partnerëve të koalicionit që e bënë të mundur këtë! Kosova Lindore, amanet!", ka shkruar Haziri.

Kosova dhe Shqipëria rrisin bashkëpunimin në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Qeveria e Kosovës në mbledhjen e së hënës ka miratuar propozimet e Ministres së Kulturës, Riniçë dhe Sportit, Vlora Dumoshi, për Kalendarin e Përbashkët Kulturor në mes të Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë, i cili nënshkruhet nga dy ministret respektive të kulturës.

Po ashtu, qeveria ka miratuar edhe marrëveshjen e cila do të nënshkruhet përbashkëprodhime filmitke në mes të Kosovës dhe Shqipërisë, e cila do ta mundësojë bashkëpunimin mes Qendrës Kinematografike të Kosovës me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë,



që do të shërbejë në prodhimin e filmit dhe forcimin e mëtejmë të lidhjeve kulturore dhe etnologjike midis dy vendave. Me këtë marrëveshje parashitet edhe ndarja e përbashkët

çmimeve për fushën e kinematografisë. Gjithashtu, është miratuar edhe memorandumi i bashkëpunimit i cili do të nënshkruhet në mes të Kosovës dhe Shqipërisë për veprimtarinë botuese dhe librit me qëllim të rritjes së shkëmbimit kulturor në këtë fushë, të qarkullimit të librit dhe të bashkëpunimit të bibliotekave kombëtare të dyja vendeve. Edhe në fushën e sportit qeveria miratoi propozimin e ministres Dumoshi për memorandumin e Ligës Unike në Basketboll e cila do të jetë një mbështetje institucionale për themelimin e një lige të përbashkët në basketboll. Ministrja Dumoshi, me rastin e

miratimit të propozimeve të MKRS-së nga ana e qeverisë, tha se janë vendime të cilat do të ndikojnë në rritjen e bashkëpunimit konkret të Kosovës dhe Shqipërisë në fushën e kulturës. "Me vendimet të cilat ka miratuar qeveria në mbledhjen e sotme, Kosovës dhe Shqipërisë i hapet rruga për shkëmbimin e përvojave në fushat e kinematografisë, të librit dhe aktivitatetëve të tjera kulturore që institucionet te ne dhe në Shqipëri i planifikojnë për t'i zhvilluar me qëllim të kultivimit të vlerave të mirëfillta kombëtare dhe me këtë rast dua ta falënderojë qeverinë Hoti pëmiratimin e këtyre nismave", u shpreh ministrija Dumoshi.

Dyfishohen subvencionet për vitin 2020



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural ka marrë dritë jeshile nga Qeveria e Republikës së Kosovës që t'i dyfishojë subvencionet krahasuar me normat e vittit 2019, për të gjitha kulturat e përfshira në Programin për Pagesa Direkte për vitin 2020. "Sivjet do t'i paguajmë dyfish subvencionet për të gjitha kulturat e përfshira në Programin për Pagesa Direkte

për vitin 2020: për grurin, misrin, elbin, cilësinë e qumështit, krerët e lopëve dhe buallicave qumështore, delet, dhitë, dosat, pulat, vreshtat, verën, bletët, mjedrën, peshkun, BMA-të dhe të gjitha kulturat dhe masat e tjera të përfshira në PPD2020", bëri me dije ministri i MBPZhR-së, Besian Mustafa, në mbledhjen e qeverisë. Më tutje, ministri Mustafa tha se ky hap është ndërmarrë si masë për t'u dalë ballë sfidave me të

cilat po ballafaqohet sektori bujqësor gjatë pandemisë Covid-19. "Prandaj, që nga dita e parë e qeverisë Hoti, si pjesë integrale e Programit qeverisës, në kuadër të Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike kemi paraparë dyfishimin e subvencioneve vetëm për vitin 2020", tha ministri Mustafa, duke shtuar se dyfishimi i subvencioneve do t'i rrisë substancialisht fondet që buqit do të kenë në xhirologaritë e tyre

për të investuar edhe më shumë në bujqësi. Me këtë dyfishim në industrinë e qumështit, cilësia do të paguhet me: 12 cent për litër të klasës ekstra, 8 cent për klasën e parë dhe 4 cent për klasën e dytë. Me nga 140 euro do të paguhet për krerë të lopëve dhe buallicave qumështore, 30 euro për dele dhe dhi. Dyfish do të paguhet edhe subvencioni për pulat vojse, 1 euro për thëllëza, 40 euro për dosa në riprodhim, 100 euro për

therjet e gjedhit në thertore të licencuara dhe 40 cent për kilogram të peshkut. Bletaria dhe mjedra sivjet do të subvencionohen me 30 euro çdo koshere dhe me 16 cent çdo kilogram i mjedrës. Për t'u siguruar që këto fonde do të shkojnë në vendin e duhur, pra për t'i ndihmuar buqit, ministri Mustafa ka paralajmëruar rritjen e kontrollit dhe monitorimit të vazdueshëm para se të realizohen pagesat.

Reçica: Nuk do të lejojmë të nëpërkëmbeni të drejtat e pensionistëve



PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka pritur të hënën në takim përfaqësues të Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës, të prirë nga Shaban Kajtazi, me të cilët ka diskutuar lidhur me angazhimet e MPMS-së për

jetësimin sa më parë të kërkesave të pensionistëve. Në këtë takim, ministri Reçica theksoi se ka dëgjuar nga afër shqetësimet e arsyeshme të tyre rrëth vonesave të paarsyeshme nga institucionet tona përkatëse, si dhe mungesës së vullnetit politik për miratimin e

nismave ligjore që e përmirësojnë dukshëm mirëqenien e pensionistëve. "Përfaqësueseve të Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës u shpreha vendosmërinë dhe përkushtimin tim për miratimin sa më parë të të gjitha akteve ligjore të cilat ndikojnë në

mirëqenien e të gjithë qytetarëve, veçmas plotësimi ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Shtetit, që i hap rrugë njohjes së stazhit të punës për punonjësit e larguar me dhunë gjatë viteve të '90-ta nga pushteti serb", ka theksuar ministri Reçica.

Në fund të këtij takimi, Lidhja së Pensionistëve të Kosovës ministri Reçica i ka shprehur gjithë gatishmërinë e tij dhe të MPMS-së dhe se në asnje moment nuk do të lejojnë që të nëpërkëmbeni të drejtat e kësaj kategorie shoqërore shumë të respektuar.

Qeveria e Kosovës ka mbajtur mbledhje të jashtëzakonshme

Qeveria ndan 87 milionë euro për bizneset dhe qytetarët



Qeveria e Kosovës ka marrë vendim për ndarjen e mjeteve buxhetore për zbatimin e Programit të Rimëkëmbjes Ekonomike në vlerë prej 87 milionë eurosh, ku 60 milionë prej tyre do të janë vetëm për mbështetje të bizneseve të cilat do të përfitojnë varësisht nga numri i punëtorëve që kanë. Kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se qeveria është duke i përbushur premtimet për ta përballuar sa më lehtë situatën e shkaktuar nga pandemja. Sipas tij, deri në fund të vitit do të ndahet edhe pjesa tjeter e fondit për rimëkëmbje ekonomike prej 365 milionë eurosh

EPOKA
E BE

Muhamet KOÇI

PRISHTINË, 28 SHTATOR - Qeveria e Kosovës ka ndarë të hënën 87 milionë euro për bizneset private dhe qytetarët, për t'i rikuperuar humbjet që kanë pësuar nga pandemia Covid-19. Nga kjo vlerë, 60 milionë euro janë ndarë vetëm për bizneset, të cilat do të përfitojnë varësisht nga numri i punëtorëve që kanë pasur të regjistruar në muajin dhjetor të vitit 2019. Pas mbledhjes së qeverisës, kryeministri Avdullah Hoti ka deklaruar se rimëkëmbja ekonomike po ndodh.

Ai ka dekluaruar se qeveriaështë duke i përmbytshur premtimet për ta përballuar sa më lehtë situatën e shkaktuar nga pandemja. "Nga 87 milionë, me 60 milionë euro do t'i mbështesim bizneset varësisht prej numrit të punësuarve që kanë. Do ta thjeshtojmë këtë çështje në maksimum, duke

mos kërkuar që bizneset të aplikojnë në qeveri apo në ministri përkatëse për të marrë këto fonde, por do të përdorim kriteri shumë të thjeshta bazuar në numrin e punëtorëve që kanë pasur në dhjetorin e vitit 2019. Mbi këtë kriter do t'i ndajmë këto mjete si subvencionim për koston e pagave që kanë bizneset në Kosovë", ka thënë Hoti, duke shtuar se kriteret për ndarjen e këtyre mjeteve janë marrë nga praktikat më të mira të vendeve të BE-së. "Këto kriteri i kemi diskutuar gjërësisht edhe me odat ekonomike dhe besoj se janë në përputhje me praktikat më të mira në vendet e BE-së për t'i ndihmuar ekonomisë me procedura të thjeshta nëpër llogari të bizneseve, duke marrë listën nga Administrata Tatinore e Kosovës për të gjitha bizneset e Kosovës", është shprehur kryeministri. Ai ka bërë me dije se deri në fund të vitit qeveria do ta realizojë zotimin që në ekonomi do t'i fusë 365 milionë euro. "Është një ndihmë e jashtëzakonshme në këtë kohë të pandemisë. Dëshiroj ta falënderoj Ministrinë e Financave për një punë të madhe. Pres që në pjesën e dytë të tetorit dhe fillim të nëntorit të ndahet edhe pjesa tjetër e fondit prej 365 milionë eurosh në mënyrë që ne ta përmbyllim vitin 2020 me 365 milionë euro që lëshojmë në ekonomi përbiznese dhe familje", ka dekluaruar Hoti.

evropiane", ka deklaruar ai. Kryeministri Hoti pret që në ditët në vijim të ndodhë ndarja e këtyre mjeteve. "Mjetet janë në dispozicion dhe besoj se për disa ditë Ministria e Financave do t'i nisë pagesat automatikisht

secilën kulturë të paraparë në Programin e Pagesave Direkte për vitin 2020), 2.5 milionë euro për fushën e kulturës, një milion për Ministrinë e Zhvillimit Rural, një milion për Zyrën për Komunitete, një milion për Agjencinë për Barazi Gjinore, dhe një milion për ndërmarrjet publike. Qeveria e Kosovës në muajin korrik ka miratuan Projektligjin për Rimëkëmbjen Ekonomike nga pandemia Covid-19, por ai nuk është miratuar ende në Kuvend.

Miratohen draft-marrëveshjet që do të diskutohen me Qeverinë e Shqipërisë

Në këtë mbledhje Qeveria e Kosovës ka shqyrtuar dokumentet dhe draftmarrëveshjet për Mbledhjen e përbashkët të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Fillimisht është aprovuar drafti i deklaratës së përbashkët ndërmjet Qeverisë të Republikës së Kosovës dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë për t'i rekomanduar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjeve të nënshkruara në mes të dy qeverive. Kurse më

nëvshëmin e plotësimin e Ligjit për përgjegjësitetë disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Programin Legjislativ të vitit 2020. Në mbledhje është aprovuar edhe Raporti Vjetor për gjendjen e mjedisit në Kosovë për vitin 2018-2019, ndërsa është vendosur që Fatos Qerimi, sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, të transferohet në pozitën sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit. Në mbledhjen e 33-të të qeverisë Hoti janë marrë edhe disa vendime të tjera që janë përgjegjësi kushtetuese dhe liqore në kabinetin qeveritar.

Fillojnë punimet për ndërtimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike në Rahovec

RAHOVEC, 28 SHTATOR (ER) - Kryetari i Komunës së Rahovcit, Smajl Latifi, ka bërë me dije se kanë filluar punimet e projektit për ndërtimin dhe trajtimin e ujërave atmosferike në qytetin e Rahovcit. Ai ka thënë se kjo komunë tash e sa vite është duke u përballur intensivisht me reshje të shiut, të cilat kanë shkaktuar vërsime dhe vështirësi të shumta në kalueshmërinë e rrugës. "Me qëllim që të gjejmë një zgjidhje permanente ndaj këtij problemi që po përsëritet tash e shumë herë, është vendosur që bashkë me inxhinierë dhe arkitektë të Komunës së Rahovcit të punojmë intensivisht dhe të dalim me një projekt i cili njëherë e mirë do t'u jepet fund problemeve të kamotshme të ujërave të rrëmbyeshëm që u kanë shkaktuar dëme ekonomive familjare dhe bizneseve që operojnë në këtë segment rrugor. Projekti 'Ndërtimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik në qytet' kap vlerën prej 248 702 57 eurosh,

gjatësia e kanalit do të jetë 560m, kanali si i tillë do të jetë me diametër të paraparë në projekt 2m me 1.30m, kanal i tipit të mbyllur dhe do të trajtohet me të gjitha elementet përcjellëse. Pas përfundimit të punimeve në kanal, do të rregullohen edhe dy shtresa asfalt", ka thënë Latifi, duke shtuar se ky projekt është vetëm fillimi i zgjidhjes së problemit të ujërave të rrëmbyeshme. "Punimet përfundimtës së projektit janë të përfundimtës së problemit të ujërave të rrëmbyeshme që përshkojnë qytetin e Rahovcit dhe ne do të vazhdojmë që këtë problem ta zgjidhim edhe në pjesët e tjera për ta normalizuar situatën me përmbytjet ose vërsimet", është shprehur Latifi.



Ferizaj shënon Ditën e Dëshmorëve



FERIZAJ, 28 SHTATOR (ER) - Komuna e Ferizajt të hënën ka shënuar Ditën e Dëshmorëve të kësaj komune. Me këtë rast janë bërë homazhe te varrezat e dëshmorëve nga personalitetë të ndryshme lokale dhe qendrore. Kryetari i kësaj komune, Agim Aliu, ka theksuar se falë dëshmorëve Kosova sot është e lirë dhe e pavarur. "Jemi të gjithë të

vegjël përballë përpjekjes titanike, veprës heroike, trimërisë legjendare të luftëtarëve të lirisë e dëshmorëve të kombit. Sot, kur qyteti ynë shënon Ditën e Dëshmorëve, po u lëmë trashëgim brezave, gjurmë historisë, përmes veprës unike të shënjimit të vendrënieve të dëshmorëve, istikameve, bunkerëve e

pozicioneve ku pushka e trimave e trimëreshave, solli lirinë e Kosovës, në Parkun Memorial të UÇK-së në Jezerç, pikën 6 të së cilës e përruam sot. Nderim e përulje sa të jetë jeta, lavdi Dëshmorëve të Kombit! Ferizajas, urime 28 Shtatorit - Dita e Dëshmorëve të Kombit të Komunës së Ferizajt!", ka thënë Aliu.

UNICEF-i dhuron donacion përfundimtës së nevojë të Skenderajt

SKENDERAJ, 28 SHTATOR (ER) - Në Komunën e Skenderajt, përmes Qendrës për Punë Sociale, organizata ndërkombëtare UNICEF ka dhuruar 100 pakë me materiale didaktike përfundimtës së cilës e përvruam sot. Nderim e përulje sa të jetë jeta, lavdi Dëshmorëve të Kombit! Ferizajas, urime 28 Shtatorit - Dita e Dëshmorëve të Kombit të Komunës së Ferizajt!", ka thënë Aliu.

fëmijët të cilët janë në gjendjen më të rëndë ekonomike. I pari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka falënderuar UNICEF-in për ndihmën e dhënë përfundimtës së fëmijët e Skenderajt, duke thënë se ndihmat e tilla janë më se të nevojshme, sidomos në këtë situatë që e ka krijuar pandemia globale Covid-19.



Prezantohet harta zonale e Komunës së Lipjanit



Lipjan, 28 shtator (ER) - Në sallën e Kuvendit Komunal është prezantuar të hënën projektdokumenti "Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028" dhe Raporti i Vlerësimit Strategik Mjedisor të HZK, me qytetarët e Zonave Urbane Lindore ZUP-3, ZUP-4, ZUP-5 dhe ZUP-6. Drejtoresha për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Emina Rexhiq, ka thënë se Harta Zonale e Komunës së Lipjanit është një

dokument mjaft i rëndësishëm "prandaj edhe po organizohen këto takime me qytetarë që së bashku të përpilohet ky dokument që ofron informata përfundimtës së nevojës së zhvillojnë pronat e tyre". Nga të pranishmit në këtë takim është kërkuar që kundërshtimet, komentet apo sugjerimet e tyre t'i paraqesin në formë të shkruar gjatë periudhës së shqyrtimit publik deri më 19 tetor 2020.

Jeta në mesin e të barabartëve dhe këshillat e Anthony Faucit



Nga Musa SABEDINI

Pandemia e njohur si Covid-19 na ka dhënë shumë shembuj dhe përvojë se jeta është e tillë për aq sa ke hapësirë veprimi e jetese. Tashmë jemi të gjithë të barabartë sepse virusi po godet të gjitha shtresat. Pse janë të logjikshme deklarimet e Anthony Fauci dhe pse mediat duhet të janë të kujdeshshme në raportimet e tyre. Vjeshta dhe dimri mund të janë edhe më sfiduese për mediat kosovare sepse termet e raportimit kërkojnë logjikë të shprehjes. Mediat e kanë lodhur publikun duke ofruar lloj-lloj eksperti e duke krijuar konfuzione të çuditshme. Fauci lehtësisht e ka ndryshuar qëndrimin e tij profesional nga "Vala e dytë" në "Sfidë". A duhet mediat e Kosovës t'i ndjekin këshillat e

Faucit!?

Kur doli në skenë virusi vdekjeprurës me shumë të panjohura, ishte një sfidë e re edhe për të gjitha shtresat dhe kategoritë brenda popullit. Tashmë po mësohem i tjetojmë në mesin e të barabartëve dhe kjo do të jetë një përvojë e mirë për shekujt vijues.

Pandemia na dha mundësi të njohim ekspertë, virologë, infektologë, epidemiologë, mikrobiologë, kimistë, farmacistë, politikanë, të gjithë në stilin e tyre duke dhënë vlerësimë e duke ofruar alternativa. Shumica pothuajse kanë dështuar sepse realisht virusi nuk linte asnjë mundësi për ndonjë parashikim emergjent.

Këta ekspertët tanë realisht vetëm mund të merren me statistika se sa dhe kush po vdes gjatë ditës, sepse për të pasur ndonjë rezultat studimor, duhet

të rrinë larg politikës e larg konferencave të shtypit.

T'i kthehem asaj çfarë dua të them me pak fjalë rrëth autoritetit të ekspertit të lartë të sëmundjeve infektive Anthony Fauci. Edhe ky ekspert bëri jo pak herë deklarata të pamatura dhe shpesh të nxitaura, megjithatë bota dhe Trump shpresat i kishin te versioni i tij, i cili shpesh konsiderohej edhe ekstrem.

Fauci duke parë ndjeshmërinë që kanë deklaratat e njerëzve kompetent në stilin: "Vjeshta nis me fazën e dytë të pandemisë", ose "Vendi po përgatitet për valën e dytë" e shumë tituj të tillë të ngjashëm, të cilët po e terrorizojnë publikun, vendosi që të bëjë një hap para në deklarimet e tija publike. Fauci po sugjeron që në vend se të thuhet "Vala e dytë" të zëvendësohet me termin: "A jemi të përgatitur përsfidën e vjeshtës dhe dimrit?".

Realisht deklarata e Fauci i përshtatet shumë medieve dhe raportimeve të tyre shpesh herë të ngutshme dhe neveritësese. Mediat online, në veçanti duhet

të mësojnë, të edukohen, të përshtaten me realitetin që është krijuar tash e gjashtë muaj. Mediat duhet të kujdesen për shëndetin e popullatës më shumë se mjeku dhe sfera shëndetësore. Publiku shpesh ka nevojë edhe për ndonjë tekst të butë, të drejtë, këshillëdhënës, edukues gjithsesi, këshilla profesionale, sesa tekste dhe tituj bombastik që ndikojnë negativisht në psikikën e qytetarëve.

Media në përgjithësi duhet të përzgjedh fjalorin gjatë raportimit, duhet të ketë kujdes maksimal nga ajo që publikohet dhe thuhet, është urgjente që media të krijojë një agjendë përményrën e raportimit, duke respektuar kriteret dhe standarde aktuale të ményrës së raportimit.

Ne shpesh mendojmë se ekspertët tanë ose ata që janë të thirrur të jalin konstatime profesionale janë të përgatitur dhe të sinqertë në atë që e thonë, por në fakt ka prej kësaj kategorie që shpesh ua kanë huqur në ekstrem. Aty ku për virusin mediat citojnë informieret dhe

politikanët, aty s'ka bereqet. Pra, media ka obligim të jetë e përgjegjshme, e përgatitur në maksimum që sfida e vjeshtës dhe e dimrit të jetë më e lehtë dhe më shumë aktive në raportimet e drejta.

Kur media raporton drejtë, saktë, dhe në ményrë objektive, i mbetet publikut pastaj ta vlerësojë se çfarë duhet të përzgjedh. Ne edhe në kohën e pandemisë kemi krijuar diferenca gjatë raportimit. Qytetarët shpesh bëhen nervozë, reagojnë në ményrë të ndryshme për raportimet tonë dhe ata shpesh detyrohen që t'i përzgjedhin qoftë portalet, gazetat apo TV e Radiot si mjete të informimit dhe komunikimit. Pse? Sepse shpesh disa media online i kanë tejkular kufijtë e etikës dhe ndërgjegjes profesionale. Pra, bëhuni pjesë e raportimit profesional, bëhuni pjesë e raportimit të shëndoshë dhe të "ëmbël" e të saktë për publikun dhe lexuesin tuaj.

(Autori është ligjërues në degën e Medias dhe Komunikimit në UBT)

Për shkak të pandemisë Covid-19, pati shumë pak gjoba të shqiptuara përmësuar

PRISHTINË, 28 SHTATOR (ER) - "Let's Do It" ka njoftuar se ka vazhduar monitorimin e zbatimit të Udhëzimit Administrativ përmësuar nga komuna e Gjelës. Mandatore si dhe të rregulloreve komunale përmësuar nga komuna e Gjelës. "Qysh në fillim kanë qenë efikase të gjitha masat e marra në bashkëpunim me inspektoratet komunale derisa koha e pandemisë Covid-19 ka bërë që këto udhëzime në shumë komuna të mos gjelënë zbatim dhe as ndëshkim përmësuar nga komuna e Gjelës. Në komunat e cilat nuk shqiptuan asnjë gjobë mandatore gjatë muajit Gusht janë: Komuna e Rahovecit, Gjakovës, Mitrovicës, Shtimes, Fushë-Kosovës, Vitisë, Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Obiliqit. Kurse nga komunat Podujevë, Vushtrri, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Junik, Suharekë, Drenas, Skenderaj, Pejë, Klinë, Malishevë nuk kemi marrë asnjë raport. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

Udhëzimit Administrativ dhe Rregulloreve Komunale kanë shqiptuar gjithsej katër gjobë. Gjobat u shqiptuan nga këto komuna: Lipjan (1), Deçan (në vend të gjobës me vlerë monetare është negociuar me kompaninë që ka bërë shkelje dhe në këmbim të gjobës kanë rënë në ujdi që të pastrohet zona përreth) Prizren (1), Istog (1).

Në komunat e cilat nuk shqiptuan asnjë gjobë mandatore gjatë muajit Gusht janë: Komuna e Rahovecit, Gjakovës, Mitrovicës, Shtimes, Fushë-Kosovës, Vitisë, Kaçanikut, Hanit të Elezit dhe Obiliqit. Kurse nga komunat Podujevë, Vushtrri, Ferizaj, Gjilan, Kamenicë, Junik, Suharekë, Drenas, Skenderaj, Pejë, Klinë, Malishevë nuk kemi marrë asnjë raport. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe



ndërgjegjësimi përmësuar nga komuna e Gjelës. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

dhe eliminimin e ndotjes së mësuarit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, po ashtu mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmësuar nga komuna e Gjelës. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

dhe eliminimin e ndotjes së mësuarit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, po ashtu mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmësuar nga komuna e Gjelës. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

dhe eliminimin e ndotjes së mësuarit dhe mbrojtjen e shëndetit të njeriut, po ashtu mbrojtjen e sipërfaqeve publike dhe private përmësuar nga komuna e Gjelës. "Vlen të theksohet se nga raportet e marra rezulton që Komuna e Mitrovicës së Jugut nuk ka fare inspektor të mësuar qysh nga muaji janar i vitit 2020. Si dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

publike të gjitha të dhënat. "Për shkak të pandemisë Covid-19 kishte shumë pak gjoba të shqiptuara gjatë muajit Gusht, por duke shpresuar në normalizim të situatës dhe në ndërgjegjen institucionale, besojmë se gjatë muajve në vijim gjobat mandatore do të gjelë zbatim në vendin tonë", dështruar që kënaqshme se si po arrihen marrëveshjet mes institucioneve dhe dëmtuesve të mësuar, duke bërë kështu që të rritet vërtësia e mësuarit. Dhe

Libri ‘Bleibende Spuren’ do të prezentohet për të dhjetën herë




Lulëzim ETEMAJ

Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag" ia ka botuar në fund të prillit të vitit të kaluar shkrimtares shqiptare me prejardhje nga Besiana e Kosovës, Basrie Murati-Sakiri, librin "Bleibende Spuren". Libri ka gjetur jehonë të madhe si në mediat e shumta të Zvicrës, po ashtu dhe te publiku, i cili që nga fillimi ka shprehur një interesim të shtuar. Deri më tani këtij libri i janë bërë 9 prezantime, të organizuara nga institucione zvicerane në qytete dhe kantone të ndryshme të këtij shteti.

Shkaku i masave mbrojtëse për parandalimin e pandemisë Covid-19, organizatorët janë detyruar t'i shtyejnë për më vonë prezantimet e parapara të mbaheshin në muajt mars, prill, maj dhe qershor. Tani, me përmirësimin e situatës, institucionet e shumta kulturore në agjendat e tyre e kanë përfshirë edhe prezantimin e mëtejshmërisë librit të shkrimit të Murati-Sakiri. Është një moment i vëçantë që do

*Eshtë një moment i veçantë dhe
i rëndësishëm për mua, kthimi*



te publiku, te lexuesit, përgjithësisht te dashamirësitë e artit dhe kulturës, të cilët me interesimin e tyre të treguar deri më tanë për librin tim më kanë dhuruar çaste dhe përjetime të veçanta. Posaçërisht ndjejë kënaqësi të madhe që sërish më jepet rasti që publikut zviceran t'ia paraqes përmes librit një kapitull të rëndësishëm të luftës së Kosovës kundër Serbisë për pavarësi dhe angazhimit tim për integrim e shkollimit si dhe përjetimet larg atdheut.

Kështu është përgjigjur shkrimtarja Basrie Murati-Sakiri në pyetjen e parashtuar nga gazeta "Epoka e re", se si po e ndjenë veten dhe çfarë do të thotë për të kthimi te publiku zviceran për të vazhduar me prezantimin e librit pas shtatë muajsh ndërprerje.

Prezentimi i radhës, i dhjeti, është paraparë të mbahet këtë tё premte, 2 tetor, duke filluar nga ora 19:00, në bibliotekën kryesore të kantonit dhe qytetit, në St. Leonhardstrasse 40, kati 3, 9000 St. Gallen
https://www.bibliosg.ch/news/bibliothek-hauptpost/2020/09/lesung_b_s_murat.html.

Fillimisht ky prezantim ishte paraparë të mbahej më datën 5 qershor. Drejtimi i prezantimit si dhe bashkëbisedimi me autoren e librit do të bëhet nga ndërmjetësja letrare Eva Bachmann, ish-redaktore



«BLEIBENDE SPUREN»



Lesung und Gespräch mit der Autorin Basrie Sakiri-Murati und Eva Bachmann.

Raum für Literatur

Freitag, 02.10.2020, 19:00

shumëvjeçare e kulturës në gazetat "Soluthurner Zeitung" dhe "St.Galler Tagblatt". Mediat e ndryshme online zvicerane, para së gjithash të kantonit St. Gallen, janë duke i kushtuar kujdes të veçantë informimit të opinionit rrëthëkëtij prezentimi.

Në fokusin e tyre zë vend portretimi i autores, si veprimtare politike e angazhuar në fund të viteve të 80-ta, kur ishte gjimnaziste 18-vjeçare, për Kosovën Republikë.

Një tregim prekës, i qetë, i këndshëm, por ndonjëherë i zemëruar i një jete midis dy botëve, dy kulturave, është një nga vlerësimet e shumta që e bëjnë mediat për librin e saj “Pleibende Spuren”

*"Bleibende Spuren".
Dhjetëshja është nota më e pëlqyer e studentëve dhe jo vetëm! Është pikërisht ajo nota e dëshiruar, të cilën e synojnë të gjithë ata që punën e tyre, krijimtarinë e tyre, jo vetëm në fushën e letërsisë, kulturës dhe artit, preferojnë apo janë të obliguar t'iia nënshtrojnë vlerësimit profesional.*

*Në këtë dhjetëshe timen,
piesëtarë meritore, me*

përkrähjen dhe kujdesin njerëzor dhe profesional,është parasëgjithash Shtëpia Botuese "Rotpunktverlag". Pjesëtarë të rendësishëm në të janë gjithashtu edhe lexuesit e shumtë të librit tim, përfshirë edhe ata që për ndonjë arsyetë caktuar nuk kanë mundur të marrin pjesë në ndonjërin nga nëntë prezentimet e mbajtura gjer më tanë, porse e kanë siguruar dhe lexuar librin tim. Prej tyre ka edhe të tillë që më janë drejtuar përmes lettrave apo formave tjera, ku kanë shprehur vlerësimin e tyre për librin. Reagimet e tillë më kanë dhuruar shpesh emocione të veçanta dhe pasuruar shpirtërisht! Iu jam tejet falenderues për mbështetjen dhe vlerësimin që të dyja u bëjnë!

Kjo ishte përgjigja që kemi marrë nga shkrimitarja Murati-Shaqiri në pyetjen, se çfarë në të vërtetë paraqet për të arritja e prezentimit të dhjetë brenda një viti, duke pasë parasysh vlerat që krijohen në Zvicër në fushën e letërsisë dhe konkurencën e madhe që mbretëron.

Duke qenë shembull i integrimit të suksesshëm; me nëntë prezantimet e deritanishme të librit në Zvicër; qindra pjesëmarrës në to; Basrie-Murati-Sakiri tashmë është shndërruar në një ambasadore të vërtet kulturore të shtetit të Kosovës dhe përgjithësisht kombit shqiptar. Më tej, autoren e kemi pyetur, se si e kanë pritur librin e saj mërgimtarët shqiptarë dhe cfarë ka qenë reagimi i tyre?

Shqiptarët kanë treguar një pjesëmarrje simbolike në prezentime. Jam ndjerë tejet mirë dhe e nderuar me interesimin që ka shfaqur si dhe prezentimin që i ka bërë librit tim Shqata e Studentëve Shqiptarë "Studenti" në

Shqiptarë, "Studenti", në Universitetin e Zürichut, ku krahas studentëve shqiptarë morën pjesë edhe ata zviceranë, është përgjigja e dhënë prej saj.

Libri "Bleibende Spuren" mund të porositet nga lexuesit jo vetëm në Zvicër, por edhe në Austri e Gjermani, edhe te "Rotpunktverlag" në këtë link:
<https://rotpunktverlag.ch/buecher/bleibende-spuren>

Haki Stërmilli, shkrimtari që u bë ateist pas krimave serbe ndaj shqiptarëve



1.

Viti 1966. Shkrimtari Nasho Jorgaqi sjell një copëz jete nga shkrimtari Haki Stërmilli. Botuar në gazetën letrare "Drita", shkrimtari thotë: Kohët e fundit na kanë rënë në dorë disa dokumente të rëndësishme, ndërmjet tyre dhe autobiografia, që hedhin drite mbi jetën e shkrimtarit Haki Stërmilli. "Është rasti, që në përkujtim të 14 vjetorit të vdekjes, t'u kujtojmë lexuesve të tij të shumtë, disa fakte mjaft interesante që saktësojnë dhe zgjerojnë njohuritë tona mbi këtë autor të nderuar të letërsisë shqipe".

Haki Stërmilli lindi me 7 maj 1895 në një familje të varfër qytetare. "Im atë", shkruan shkrimtari në autobiografi, "nuk trashëgoi gjë nga prindërt e vet. Im ame kishte trashigue nji sasi toke por kjo ishte shite ma vonë për nevoja te familjes... Familja erne... ishte ne lagjen ma të vorfën të Dibrës, ku banojshin njerëz që me krah e sigurojshin bukën...".

Shkrimtari i ardhshëm u rrit në kondita te vështira, në një ambient besimtarësh dhe u edukua që për së vogli me një fryme fetare. Kjo gjë la gjurmët e saj tek ai, po vetë jeta e bëri shpejt ateist. Dhe, kjo ndodhi pas masakrave dhe padrejtësive që bënë shovinistet serbomedhenj, në kuriz të popullsisë së krahinës së Dibrës. "Atëherë", shkruan ai, "ndiva në vetvete nji revolution shpirtnuer

dhe u binda se nuk kishte drejtësi hyjnore. Qysh atëherë u bana atheist".

Mësimet Haki Stërmilli i bëri në vendlindje e pastaj në Selanik dhe i kreu në gjimnazin e Manastirit. Qeveria e Ismail Qemalit i akordoi bursë për të ndjekur studimet e larta jashtë, por vdekja e të vëllait gjatë Luftës Ballkanike, e detyroi të rrijë pranë familjes. E, jo vetëm kaq, po sipas një zakoni të egër të kohës, ai duhej të martohej me të vejën e të vëllait. Megjithë kundërshtimin e vendosur, për disa vjet me radhë, Haki Stërmilli u detyrua t'i nënshtrohet këtij zakoni kur ishte ende 20 vjeç. Këtë ngjarje të rëndë ai nuk do ta harrojë dhe më vonë tërthorazi do ta shprehë në romanin "Sikur të isha djalë". Drama e Dipes është në fakt drama e vete autorit. Revolta dhe patosi i fortë i kësaj heroine të rebeluar ndaj ambientit fanatik të kohës, shpjegohen mjaft mirë dhe me disa motive personale të vetë shkrimtarit.

2.

Shkrimtari N. Jorgaqi sjell më vonë jetën politike të Haki Stërmillit. "Jetën politike, Haki Stërmilli", shkruan autorri, "e ka filluar që shpejt. Qysh më 1907 ai mëson të këndoje shqip dhe propagandon idetë e rilindjes e mësimin e gjuhës amtare. Kur vjen në Shqipëri, më 1913, vihet menjëherë në shërbim të shtetit shqiptar, duke marrë nëpunësi

të ndryshme, i frysmeuar nga ideale patriotike. Këto ideale dhe përqafimi i ideve përparimtare të kohës e lidhin Haki Stërmillin me ato forca që luftonin kundër feudalizmit për interesat e popullit. Agitacioni i Avni Rustemit -shkruan Hakiu - m'i pat hapë sytë dhe pat ba efekt në mue. Kjo shpjegon faktin pse Haki u shkëput shpejt nga influenca e ndonjë personaliteti negativ të kohës dhe pas vdekjes së A. Rustemit, në Kongresin e shoqërisë 'Bashkimi' (gusht 1924) u zgjodh sekretar i përgjithshëm i saj".

3.

Duke vijuar më tej me periudhën e emigracionit të shkrimtari H. Stërmilli, autorri thotë: "Periudha e emigracionit (1924-1929) në jetën e shkrimtarit është e mbushur plot aktivitete politike. Ai endet, me detyra të caktuara, nëpër vende të ndryshme të Evropës, gjithnjë në luftë kundër fashizmit dhe regjimit te Zogut. Zgjidhet anëtar i Komitetit të Konares, që në themelimin e saj. Bashkëpunon me shtypin antizogist, bile dhe atë komunist, duke shkruar artikuj politike si në gazetën 'Liria kombëtare' dhe 'Federasjon Ballkanik', organ që dilte në Vjenë, nën drejtimin e Gjergj Dimitrovit. Jeton rrëth 14 muaj në Bashkimin Sovjetik. Zhvillon aktivitete antifashiste në Austri e Itali. Përjashtohet nga këto vende dhe detyrohet të hyjë në Jugosllavi Atje autoritetet e

arrestojnë e pastaj e internojnë në Mitrovicë. Për këtë periudhë, H. Stërmilli shënon në mes të tjera: "...megjithë që nuk isha komunist dhe nuk kuptoja nga marksizëm-leninizmi, u përhoqatë formoj me njerëz përparimtarë celula komuniste në Dibër, në Strugë, e në Manastir".

4.

Periudha pas viteve 1920. Ja çfarë shkruan autorri N. Jorgaqi: "Në mars te vitit 1929, ai arrestohet nga autoritetet jugosllave dhe, duke u trajtuar si një kriminel ordiner, i dorëzohet Zogut. Ky akt i qeverisë jugosllave ngjalli zemërim në qarqet përparimtare të kohës, nëpër vendet e ndryshme te Evropës. Personalitetet të shquara, si Gjergj Dimitrovi, Anri Barbysi, Albert Ajshajni etj., protestuan për këtë akt arbitrar të qeverisë jugosllave, që binte në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare dhe kërkuan nga sekretariati i Lidhjes së Kombeve sigurimin dhe shpëtimin e demokratit revolucionar shqiptar. Dhe, fakti që gjyqi politik i Zogut e dënoi Haki Stërmillin vetëm me pesë vjet burgim, shpjegohet dhe me ndikimin që ushtroi fushata për shpëtimin e tij në Evropë. Koha e burgut qe për shkrimtarin një periudhë e rëndë. Zogu tregohet i pamëshirshëm ndaj armiqve të tij, sidomos ndaj atyre që e kishin njohur nga afër dhe më vonë e kishin demaskuar si kish

vepruar Haki Stërmilli. Lufta Nacional-Çlirimtare i hapi horizont patriotit të vjetër demokrat. Fill pas Konferencës se Pezës ai u radhit me Frontin Nacional Çlirimtar. Ai është nga intelektualet e parë që përqafoi pa hezitim vijën e drejtë të PKSh. për një luftë të vendosur kundër fashizmit. Që në fillim, Haki Stërmilli kryeson një këshill Nacional-Çlirimtar të intelektualeve në Tiranë dhe propagandon idealet e luftës. Në verën e vitit 1943, ai hidhet në ilegalitet. Së pari në çetën e Slloves, e pastaj në krahinën e Dibrës shkrimtari partizan vë në shërbim te Lëvizjes gjithë forcat e veta morale e intelektuale, duke qene gjithnjë i bindur në drejtësinë e vijës së partisë".

5.

Këto janë disa nga të dhënat e reja që hedhin drite në jetën e shkrimtarit tonë, thotë studiuvesi dhe shkrimtari Nasho Jorgaqi në artikullin kushtuar Haki Stërmillit në 14 vjetorin e vdekjes së shkrimtarit. "Ai vdiq në një moshë kur mund t'i jepte akoma letërsisë sonë. Po veprat e shumta që ka lënë në dorëshkrim dhe veçanërisht ditari i luftës: "Shtigjet e lirisë", dy romanet, njëri nga koha e Skënderbeut e tjetri kushtuar luftës së rinisë sonë antifashiste, janë një kontribut i çmuar i shkrimtarit, ndonëse të panjohura akoma nga masa e lexuesve". *Gëzim Llojdia/ Marrë nga Telegrafi*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS –SUHAREKË
SKUPUSTINA OPSTINE SUVA REKA
MUNICIPALITY –SUHAREKË



Kryetari i Komunës 01-nr.465- 95029 Dt. 21.09.2020

Suharekë

Ne bazë të nenit 11 paragrafit 1 dhe 2, lidhur me nenin 4 te Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme Nr.03/L-139 dt. 26.mars 2009 te Republikës së Kosovës dhe Ndryshim plotësimi i Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Palujtshme nr.03/L-205 dt.10.dhjetor 2010, nenit 44 te Ligjit për Procedurën e përgjithshme Administrative 03/L-031, pas shqyrtimit te komenteve dhe deklaratave te palëve, brenda afatit ligjor, si dhe duke u bazuar në Vendimin për pranimin formal të kërkesës për shpronësim te paluajtshmerise 01 nr.465-4046/20, dt. 13.01.2020, Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit të propozuar 01. nr.465-221219, dt. 04.06.2020 për shpronësimin e paluajtshmerisë për ndertimin e trases dhe murit te lumit në Suharekë, Kryetari i Komunës së Suharekës, brenda afatit ligjor, merr këtë :

VENDIM

(PËRFUNDIMTAR)

I. Shpronësohet paluajtshmeria për interes publik dhe për ndertimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në fshatin Bukosh e cila gjendet në pjesën e ngastrës kadastrale me nr. P-72116036-01164-0, në sip. prej: **6000 m²** (nga sip. e përgjithshme prej: 9961 m²) ZK. Reqan, pronë private e evidentuar në emër të **Fatmir (Hysen) Baraliu** nga fshati Bukosh.

II. Vërtetohet se ndërtimi i impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura është qëllim i ligjshëm dhe interes publik dhe se shpronësimi i paluajtshmerisë së lartëcekur është në shërbim te arritjes së këtij qëllimi.

III. Pronari i paluajtshmerisë për pjesën e ngastrës kadastrale te shpronësuar si në pikën 1. të ketij Vendimi, kompenzohejt në shumën prej: 6.50 € (gjashtë uro e pesdhjet cent) për m². Ndërsa për siperaqën e përgjithshme te shpronësuar prej: 6000 m², kompenzohejt në shumën totale prej: **39,000,00 €**. (Tridhjet e nend mij euro).

Vlerësimin për kompenzimin e paluajtshmerisë e ka bërë organi kompetent, respektivisht Ministria e Financave- Departamenti i Tatimit në Pronë në Prishtinë.

VI. Vendimi Përfundimtar hyn ne fuqi datën e shpalljës në një Gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Arsyimet

Subjekti kërkues-K.R.U "Hidroregjioni Jugor" – njesia punuese në Suharekë, me kërkesën nr. 104-65973 te datës 18.09.2019, ka kërkuar nga Kryetari i Komunës së Suharekës iniciimin e procedurës se paluajtshme për interes publik dhe për ndertimin e impiantit për trajtimin biologjik të ujërave të ndotura në fshatin Bukosh, , si ne dispozitiv te ketij vendimi.

Subjekti kërkues, kësaj kerkese ia ka bashkangjitur dokumentacionin e nevojshem i cili parashihet me dispozitat e nenit 8, lidhur me nenin 4. të Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organji shpronësues pas shqyrtimit te kërkesës ka ardh ne përfundim se shpronësimi i paluajtshmerisë te evidentuar si në dispozitiv te këtij Vendimi është interes publik dhe i domosdoshëm për arritjen e të njejtit qellim dhe se shpronësimi ne fjalë prek të drejtën private, se pjesa e pronës se paluajtshme e cila është objekt shpronësimi nuk është zgjidhur për arritjen e një qellimi ose synimi diskriminues dhe se Organji shpronësues lidhur me këtë qështje është bazuar në të gjitha dispozitat e aplikueshme te Ligjit për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme.

Organji shpronësues-Kryetari i Komunës ka miratuar kërkuesin e subjektit kërkues për shpronësimin e pronës së paluajtshme për interes publik. me Vendimin për pranimin formal të kerkues së shpronësim 01 nr.465-4046/20, dt. 13.01.2020.

Poashtu ne afatin ligjor, organji shpronësues ka miratuar Vendimin Preliminar për ligjëshmerinë e shpronësimit te propozuar 01. nr.465-221219, dt. 04.06.2020.

Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas miratimit, të Vendimit Përfundimtar, Organji shpronësues, këtë Vendim ia dërgon subjektit kërkues dhe personave të tjerë të cilët duhet të identifikohen ne Vendimin Përfundimtar.

Prandaj duke qenë se janë plotësuar kushtet ligjore për iniciimin e procedurës së shpronësimit dhe se kërkesa e subjektit kërkues për shpronësimin është e bazuar, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Udhëzime Juridike: Kundër këtij Vendimi, pala e paknaqur ka të drejtëne paraqitjës së ankesës për kundershtimin e tij, në Gjykatën Themelore në Prizren- Dega në Suharekë, në afat prej 15 ditëve kalendarike pas datës se hyrjes në fuqi të ketij Vendimi. Në të njejtën ditë në të cilën parashtruesi i ankesës e dorëzon ankesën në Gjykatë, parashtruesi i ankesës duhet që menjëherë dhe drejtëpërdrejt të dorëzoj në zyrën ligjore të Organit Shpronësues pesë (5) kopje të sakta dhe të plota të ankesës duke përfshirë të gjitha dokumentet përcjellëse (konform nenit 35 alinea 3 e Ligjit për Shpronësim).

Vendimi i dergohet:

Subjektit kërkues

Pronarit dhe zotëruesit të interesit dhe

Arkivit



NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "AGROFLORENCE", SH.P.K. ka marrë vendim të shuaë biznesin me nr. 810197245, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore – Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavame se svi klienti da drustvo "AGROFLORENCE", D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nr. 810197245, ujedno imenova Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "AGROFLORENCE", L.L.C.. has come to the decision to quit its nr. . 810197245, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

Klinë, 28.09.2020



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë. Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731

Ylkena Demaku shpall të pavlefshme dëftesat si dhe diplomën e shkollës së mesme të Muzikës "Prenk Jakova" Prishtinë.

Anita Avni Mazrekull shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së dhjetë të Gjimnazit "Sami Frashëri" Prishtinë.

Bekim Muhadri shpall te pa vlefshme dëftesën e plotë të Sh.F.M.U. "Pjeter Bogdani" në Damjan KK Gjakovë.

Faton Pula shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e Kolegjit "Mehmet Akif" në Prizren.

Donat Bytyqi shpall të pavlefshme dëftesat dhe diplomën e certifikatën e maturës shkolla "Qendra e Kompetencës" në Prizren.

Ermira Morina nga Drenasi shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti – Skënderbeu"

Jap banesë me qira afér 60 m², katë III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplekt, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m², me inventar të komplektuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërllok, Tel: 044-608-626.

Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muhamrem Fejza", banesa është 70 m² dhe i plotëson të gjitha kushtet, katë dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muhamrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m², katë dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian katë i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana katë i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

Urgjentishit kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "VERMITTLUNGSAENTUR VITA" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 810181678, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "VERMITTLUNGSAENTUR VITA", D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 810181678, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "VERMITTLUNGSAENTUR VITA" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 810181678, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se "M&D Natural Products Factory" SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me NRB: 811312123, dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestanje se svi klienti da drustvo sa "M&D Natural Products Factory", D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa bisnisom: 811312123, ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljinjanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the "M&D Natural Products Factory" L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811312123, the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

 N.P.L. "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJAKOVË KE: 0390/ 320 010 E-mail: nplsagi@gmail.com Info: 0390/ 324 268 Web: Nr. Biznesit: 71228673 Nr. Fiskal: 601568233 Nr. TVSH: 330311853 BEK: 1402000001784638
<p>Në mbështetje të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, të Republikës së Kosovës, nenit 4 pika 1,2,3,4,5 dhe nenit 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për Regullimin e Porcedurave të Konkursit në Sektorin Publik, nenit 3 të Regullores nr.167 të datës 06.05.2016 mbi Mardhënien në Punë të Punëtorëve dhe nenit 3 pika 1, 2 dhe 3 të Rregullores 306 / 23.09.2020 për Ndryshim – Plotësimin e Rregullores per Organizimin e Mbrendshëm, Caktimin e Pozitave, Detyrave dhe Përgjegjësive të Stafit Punues nr.121 të dt. 04.04.2016, dhe vendimit nr. 307 të datës 25.09.2020 të Kryeshefit Ekzekutiv, N.P.L."Stacioni i Autobusëve"SH.A.,Gjakovë, shpallë këtë:</p> <p style="text-align: center;">KONKURS</p> <p>Pozita: Udhëheqës i Kontrollit të përgjithshëm</p> <p>Numri i pozitave: 1 (një)</p> <p>Kohëzgjatja e punës: 1 (një) vit me mundësi vazhdimi</p> <p>Detyrat dhe përgjegjësit:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Kontrollin e përgjithshëm të punës së punëtorëve në Ndërmarrje; -Kontrollon sigurinë e përgjithshme në Ndërmarrje dhe merr informata që kanë të bëjnë me shërbimet e sigurisë dhe të mbrojtjes së objektit; -Kontrollon dhe ndihmon punonjësit në aplikimin e metodologjive të reja në mbarëvajtjen e proceseve të punës; -Kontrollon dhe mban ditarin e punës në të cilën evidenton inspektimin, vërejtjet dhe veprimet e ndërmarrja, -Në bashkëpunim me shefin e stacionit evidenton çdo veprim të jashtëligjëshëm duke e përcjellur te KE; -Për të metat e vërejtura gjatë orarit mbanë shenime dhe i evidenton personat apo grupet të cilat hasin në konflikt të thyerjes së regullave të Ndërmarrjes -Për ndërlukeshmërinë gjatë kryerjes së punës i përgjigjet Shefit të Stacionit dhe Kryeshefit Ekzekutiv ; -Mban shënime përrastet e veçanta. -Mbanë evidencë përkonstatimin e parregullsive, jep ide për menjanimin e tyre dhe i raporton ato te Shefi Stacionit; -Mbanë evidencë, përcjellë dhe është përgjegjës për punët që zhvillohen në Stacion; -Krijon dhe kultivon raporte të ndërsjellta me operatorë; -Kryen punë dhe detyra tjera të përcaktuara nga Shefi Stacionit dhe KE; -Për punën e tij i përgjigjet Shefit Stacionit dhe KE. <p>Kushtet për pjesmarrje : Kualifikimi dhe Aftësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Diplomë universitare -1(një) vit përvjetorë pune -Shkathësi në punë dhe njohja e punës me programe kompjuterike. <p>Dokumentacioni i kërkuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Diploma mbi shkollimin. -Dëshmë mbi përvjetorë pune. -Kopja e letërnjoftimit. -Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më te vjetër se 3 muaj; <p>Informata të përgjithshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> -Të drejtë aplikimi për këtë konkurs kanë të gjithë qytetarët pa dallim. -Ndërmarrja ofron mundësi të barabarta, inkurajon dhe promovon angazhimin e punëtorëve, pjestarë të të gjitha komuniteteve dhe gjinive të ndryshme. -Testimi me shkrim dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim sipas ligjit. <p>Mënyra e aplikimit:</p> <p>Aplikacioni për punësim tërhiqet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kat. II, zyra nr.2.</p> <p>Dorëzimi i aplikacionit bëhet në Zyrën e Shërbimit Juridik, kat. II, zyra nr.2 tek Stacioni i Autobusëve në Gjakovë, në pliko të mbyllur, çdo ditë pune, nga ora 08:00 deri në ora 14:00. Konkursi është i hapur nga data 29.09.2020 – 13.10.2020.</p> <p>Kandidatët të cilët konkurojnë duhet ta shënojnë saktë adresën e banimit dhe numrin e telefonit kontaktues, apo dhe e-mail adresën.</p> <p>Vërejtje: Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta huden poshtë.</p> <p>Gjakovë, më 28.09.2020</p> <p style="text-align: right;">Kryeshefi Ekzekutiv – Flamur Bieurrri</p> <p style="text-align: right;">   </p>



Posta e Kosovës Sh. A.
FILATELIA E POSTËS SË KOSOVËS

SHPALL KONKURS

Për dizajne artistike të motiveve për pulla postare dhe bloque filatelike për programin e rregullt të pullave postare për vitin 2021

Në kuadër të programit vjetor 2021 të pullave postare, do të përzgjidhen dizajnet më të bukura për emisionet si vijojnë më poshtë:

1. Tematika e emisionit: **“40 Vjetori i Demonstratave të vitit 1981”**. Përshkrimi: Prezantim artistik i Demostratave në, pikturë, fotografji artistike, grafikë etj. Shpërblimi: Vend i parë €300, vendi i dytë €250.
2. Tematika e emisionit: **”Kroi i Gorozhubit, Kroï i Siqevës dhe Kroï i Mbretit”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike e krojeve në pikturë, vizatim, grafikë, apo foto artistike. Shpërblimi: Vend i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200.
3. Tematika e emisionit: **Evropa 2021 - Shtazët e egra të rezikuara vendore (kaprolli, ariu i murrmë)**. Përshkrimi: Prezantim artistik i shtazëve të egra të rezikuara në territorin e Kosovës, në:pikturë,vizatim, fotografji artistike, grafikë etj. Shpërblimi: Vend i parë €300, vendi i dytë €250, blloku filatelik €350.
4. Tematika e emisionit: **“Frutat e malit - qershizë mal, dredhëza mal, mjedra”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike e frutave në vizatim, pikturë, grafikë, fotografji etj. Shpërblimi: Vend i parë €300, vendi i dytë €250, vendi i tretë €200, blloku filatelik €350.
5. Tematika e emisionit: **“Nga trashëgimia - hedhja e gurit, luajta me shkop etj”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike lojratave tradicionale në, vizatim, pikturë, fotografji, grafikë etj. Shpërblimi: Vend i parë € 300; vendi i dytë € 250. Përshkrimi: Paraqitura artistike në pikturë, fotografji, vizatim, grafikë etj. Shpërblimi: Vend i parë € 300; vendi i dytë €250; vendi i tretë € 200; vendi i katërt €150
6. Tematika e emisionit: **“30 Vjetori i Referendumit të Pavarësisë”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike në vizatim, grafikë, fotografji artistike, pikturë etj. Shpërblimi: Vend i parë €300.
7. Tematika e emisionit: **“Pëllumbi Ilir (Columba Ilyrica)”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike në vizatim, grafikë, fotografji artistike, pikturë etj. Shpërblimi: Vend i parë € 300.
8. Tematika e emisionit: **“Nga zejtaria”**. Përshkrimi: Paraqitura artistike e zejtarisë vendore në vizatim, grafikë, fotografji artistike, pikturë etj. Shpërblimi: Vend i parë € 300; vendi i dytë €250; blloku filatelik €350.

RREGULLAT E KONKURRIMIT:

- Dizajnet artistike të bazuara në këto tema duhet të punohen në programe të specializuara për dizajn (Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, apo pamje nga piktura, fotografji, vizatime personale etj, të përpunuara grafikisht); të njëjtat duhet të dorëzohen të shtypura dhe në fajl kompjuterik.
- Punimet me rezolucion më të ultë se **500 px**.(TIFF ose PDF) nuk pranohen.
- Emri i autorit të dizajnit nuk duhet të shënohet pranë motivit konkurrues, aty duhet të duket vetëm shifra.
- Dizajnet konkurruese për këtë konkurs duhet të dorëzohen në zarfe të myllura.
- Një autor mund të konkurrojë me numër të pacaktuar të punimeve, mirëpo me shifra të ndryshme për secilin emision.
- Punimet e printuara konkurruese me CD vendosen në zarf, i cili duhet të përbajë edhe zarin e myllur me shënimet personale të autorit.
- Punimet konkurruese për emisione të ndryshme duhet paketuar veçmas, duke e shënuar mbi zarf titullin e emisionit për të cilin konkurroni dhe shifrën.
- Përgjegjësinë mbi të drejtat autoriale e mban autorit i dizajnit (konkurrues).

Për shkak të konfidencialitetit dhe për shkak të objektivitetit, në pjesën e jashtme të zarfeve dhe në CD duhet të shënohet vetëm shifra e zgjedhur nga vet autorit (askund në punime nuk duhet të duket emri apo mbiemri i autorit, vetëm shifra).

Komisioni i Pullës Postare, gjatë përzgjedhjes së dizajnëve, nuk do të ketë qasje në shënimë autoriale, por ka të drejtë të verifikojë mbi originalitetin e dizajnëve të përzgjedhur.

PK Sh.A. do t'i bartë obligimet tatimore.

KONKURSI do të jetë i hapur 40 ditë kalendarike, prej datës: 01.10.2020 deri më 09.11.2020 dhe do të jetë i publikuar në ueb faqen: www.postakosoves.com.

Punimet konkurruese nuk do t'i kthehen autorëve.

Zgjedhjen e punimeve më të mira konkurruese, duke u bazuar në dizajnin më të mirë dhe ndarjen e shpërblimeve do ta bëjë Komisioni i Pullës Postare.

Punimet duhet dorëzuar, apo dërguar në këtë adresë:

FILATELIA
Për Konkurs-Filateli
Ndërtesa e Postës së Kosovës p.n.
Fushë Kosovë 12000
Republika e Kosovës

Për informata shtesë mund të thërrisni në numrin e telefonit: +381(0)38 246 770, apo të drejtoheni në e-mail adresën: filatelia@postakosoves.com, ose në ueb faqen www.postakosoves.com.



Post of Kosovo J.S.C.
PHILATELY OF POST OF KOSOVA

ANNOUNCES COMPETITION

For artistic designs of motifs for postage stamps and philatelic blocks, for the regular postage stamp program for 2021.

As part of the 2021 Annual Postage Stamp Program, the most beautiful designs shall be selected for the following editions:

1. Stamp theme: “40th Anniversary of the 1981 Demonstrations” Description: Artistic presentation of Demonstrations in painting, artistic photography, graphics, etc. Remuneration: First place € 300, second place € 250.
2. Stamp theme: “The spring water of Gorozhub, Siqeva spring water, and King’s spring water” Description: Artistic representation of fountains in painting, drawing, graphics, or artistic photography. Remuneration: First place € 300, second place € 250, third place € 200.
3. Stamp theme: “Native endangered wildlife – roe deer, brown bear” Description: Artistic representation of endangered wildlife in the territory of Kosovo in painting, drawing, artistic photography, graphics, etc. Remuneration: First place € 300, second place € 250, philatelic block € 350.
4. Stamp theme: “Mountain fruits - mountain cherries, strawberries, and raspberries.” Description: Artistic representation of fruits in drawing, painting, graphics, photographs, etc. Remuneration: First place € 300, second place € 250, third place € 200, philatelic block € 350.
5. Stamp theme: “From the heritage - throwing stones, playing with sticks, etc.” Description: Artistic representation of traditional games in, drawing, painting, photography, graphics, etc. Remuneration: First place € 300; second place € 250.
6. Stamp theme: "30th Anniversary of the Independence Referendum". Description: Artistic representation in drawing, graphics, artistic photography, painting, etc. Remuneration: First place € 300.
7. Stamp theme: "The Illyrian Pigeon (Columba livia)" Description: Artistic representation in drawing, graphics, artistic photography, painting, etc. Remuneration: First place € 300.
8. Stamp theme: "From handicrafts" Description: Artistic representation of local handicrafts in drawing, graphics, artistic photography, painting, etc. Remuneration: First place € 300; second place € 250; philatelic block € 350.

COMPETITION RULES:

- Artistic designs based on these themes should be done in specialized design programs (graphically processed in Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw, or drawings of paintings, photographs, personal drawings etc.); the same should be submitted in hard copy and in a computer file.
- Works with a resolution lower than 500 px (TIFF or PDF) are not accepted.
- The design author's name should not be marked next to the competing motif, only the digit codes should appear there.
- Competitive designs for this competition must be submitted in enclosed envelopes.
- One author may compete with an indefinite number of works, but with different digit codes for each stamp theme.
- Competitive printed works along with the CD, should be placed in an envelope, which must also contain the enclosed envelope with the author's personal information.
- Competitive works for different stamp themes should be packed separately, marking on the envelope the title of the theme for which you compete and the digit code.
- The copyright liability is the responsibility of the design's author (competitor).

For reasons of confidentiality and due to objectivity, only the digit code chosen by the author should be written on the outer part of the envelopes and on the CD (nowhere in the works should the author's name or surname appear, only the digits).

The Postage Stamp Commission, while selecting designs, shall not have access to copyrighted notes, but has the right to verify the authenticity of the selected designs.

PK JSC will bear tax liabilities.

The COMPETITION will be open 40 calendar days, from 01.10.2020 to 09.11.2020 and will be published on the website www.postakosoves.com.

Competitive works will not be returned to the authors.

The selection of the best competitive works based on the best design and awarding of prizes shall be made by the Postage Stamp Commission.

Works must be submitted or sent to the following address:

PHILATELY
For the Philately Competition
The Post of Kosovo Building n. n.
Fushë Kosovë 12000
The Republic of Kosovo

For additional information, you reach us on this number 381 (0) 38 246 770, or contact us at the e-mail address filatelia@postakosoves.com, or on the official web site www.postakosoves.com.



Pošta Kosova A.D.

FILATELIJA POŠTA KOSOVA

OBJAVLJUJE KONKURS

za umetnički dizajn poštanskih marki sa motivima i filatelijske blokove, za redovni program poštanskih maraka za 2021. godinu.

Kao deo godišnjeg programa poštanskih maraka za 2021. godinu, najlepši dizajni biće izabrani za sledeća izdanja:

1. Tematsko izdanje: „40. godišnjica demonstracija 1981“

Opis: Umetničko predstavljanje demonstracija u slikarstvu, umetničkoj fotografiji, grafici itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €, drugo mesto 250 €.

2. Tematsko izdanje: „Česma Gorožupa, česma Siceva, i Kraljeva česma“

Opis: Umetničko predstavljanje česma u slikarstvu, crtanju, grafici ili umetničkoj fotografiji.
Nagrada: Prvo mesto 300 €, drugo mesto 250 €, treće mesto 200 €.

3. Tematsko izdanje: „Evropa 2021 – Zavičajni ugroženi divlji svet (srna, mrki medved)“

Opis: Umetnička reprezentacija ugroženih divljih životinja na teritoriji Kosova u slikarstvu, crtežu, umetničkoj fotografiji, grafici itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €, drugo mesto 250 €, filatelistički blok 350 €.

4. Tematsko izdanje: „Planinsko voće - planinska trešnja, planinska jagoda, malina“

Opis: Umetničko predstavljanje voća u crtanju, slikanju, grafici, fotografiji itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €, drugo mesto 250 €, treće mesto 200 €, filatelistički blok 350 €.

5. Tematsko izdanje: „Iz baštine - bacanje kamenja, igre sa štapom itd.“

Opis: Umetničko predstavljanje tradicionalnih igara u crtanju, slikanju, fotografiji, grafici itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €; drugo mesto 250 €.

6. Tematsko izdanje: „30. godišnjica referendumu o nezavisnosti“

Opis: Umetničko predstavljanje u crtežu, grafici, umetničkoj fotografiji, slikanju itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €.

7. Tematsko izdanje: „Ilirski golub (Columba livia)“

Opis: Umetničko predstavljanje u crtežu, grafici, umetničkoj fotografiji, slikanju itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €.

8. Tematsko izdanje: „Od rukotvorine“

Opis: Umetničko predstavljanje lokalnih rukotvorina u crtežu, grafici, umetničkoj fotografiji, slikanju itd.
Nagrada: Prvo mesto 300 €; drugo mesto 250 €; filatelistički blok 350 €.

PRAVILA KONKURSA:

- Umetnički dizajn zasnovan na ovim temama treba izvoditi u specijalizovanim programima za dizajn (grafički obrađeni u Adobe Photoshop, Illustrator, Corel Draw ili crteži slike, fotografija, ličnih crteža, itd.), isti treba dostaviti u štampanoj kopiji i u kompjuterski fajl.
- Radovi sa rezolucijom manjom od 500 px (TIFF ili PDF) nisu prihvaćeni.
- Ime autora dizajna ne treba da bude označeno pored konkurenetskog motiva, tamo treba se pojaviti samo kodovi cifra.
- Konkurencki dizajni za ovaj konkurs mora se dostaviti u zatvorenim kovertama.
- Jedan autor se može takmičiti sa neodređenim brojem radova, ali sa različitim ciframa kodova za svaku temu poštanske marke.
- Konkurentni štampani radovi zajedno sa CD-om treba staviti u kovertu, koja takođe mora sadržati priloženu zatvorenu kovertu sa ličnim podacima autora.
- Konkurencki radovi za različite teme izdanja treba spakovati odvojeno, označivši na koverti naslov teme za koju se takmičite i cifreni kod.
- Odgovornost za autorska prava je obaveza autora dizajna (konkurenta).

Iz razloga poverljivosti i zbog objektivnosti, na spoljnem delu koverti i na CD-u treba da bude isписан samo cifreni kod koji je autor izabrao (nigde u radovima ne smeju da se pojavljuju ime ili prezime autora, samo cifre).

Komisija za Poštanske Marke tokom odabira dizajna neće imati pristup beleškama zaštićenim autorskim pravima, ali ima pravo da poroveri autentičnost izabranih dizajna.

PK Sh.A. snosiće poreske obaveze.

KONKURS će biti otvoren 40 kalendarskih dana, od 01.10.2020 do 09.11.2020 i biće objavljen na web stranici www.postakosoves.com.

Konkursni radovi neće biti vraćeni autorima.

Izbor najboljih konkurenetskih radova na osnovu najboljeg dizajna i dodelu nagrada vrši Komisija za Poštanske Marke.

Radovi se moraju predati ili poslati na sledeću adresu:

FILATELIJA

Za Konkurs u Filateliji
Zgrada Pošte Kosova b.b.
Kosovo Polje 12000
Republika Kosova

Za dodatne informacije možete nas kontaktirati na ovaj broj telefona +381 (0) 38 246 770 ili nas kontaktirajte nas putem e-pošte: filatelia@postakosoves.com, ili na zvaničnoj web stranici www.postakosoves.com.

Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

[lumesdetails](#)

Mbrapa Teatr-it, 4 Llullat, Rr. Bajram Kelmendi

Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë

[facebook](#) www.facebook.com/gjejpuneshepeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

PRISHTINË



The advertisement for RC Cola features a dark blue background with a central yellow rectangular box. At the top of this box is the 'ROYAL CROWN' logo, followed by the 'RC' logo with 'cola' underneath. Below the logo, the text 'ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS' is displayed in large, bold, blue capital letters.

Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A Paraguay, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
- ★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales

On the right side of the advertisement, there is a blue can and a dark plastic bottle of RC Cola standing on a wooden surface. The can has 'RC' and 'cola' on it, along with 'Columbus, Georgia, USA' and 'Since 1905'. The bottle also has 'RC' and 'cola' on it, along with 'Columbus, Georgia, USA' and '0.5L'.